



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**

Nr. 442/5 prot.

Tiranë më 3.7.2018

**VENDIM**

Nr. 28, datë 3.7.2018

**PËR**

**URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

**KONSTATOVA SE:**

Ankuesi, Qendra “Res Publica”, përfaqësuar nga Av. \_\_\_\_\_ ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) ankesën nr. 442 Prot., datë 02.03.2018, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtare” ndaj Autoritetit Publik/Institutit të Statistikave (në vijim “Autoriteti Publik”). Ankuesi në cilësinë e kërkuarit, me shkresën e datës 06.02.2018 ka kërkuar nga Autoriteti Publik t’i vihen në dispozicion dokumentacioni dhe informacioni i disponueshëm lidhur me:

1. Sa është numri i call center që operojnë në Tiranë?
2. Prej sa vitesh operojnë këto call center në Tiranë?
3. Sa është numri i të punësuarëve në secilën prej këtyre call center?
4. Cilët janë 10 Call center më të mëdhenj që operojnë në Tiranë në bazë të numrit të punonjësve?

Autoriteti Publik me shkresën nr. 191/1 Prot., datë 19.02.2018 ka kthyer përgjigje pjesërisht, duke dhënë informacion në lidhje me numrin e Call Center që kanë operuar nga viti 2011 deri në vitin 2016 në Shqipëri dhe në qytetin e Tiranës, si dhe ato që rezultojnë aktive në fund të këtij viti.

Për pjesën tjetër të kërkesës për informim, Autoriteti Publik ka argumentuar se: “Nuk mund të japë informacionin e kërkuar referuar Ligjit për Statistikat Zyrtare, neni 15, pika

5, “ Të gjitha të dhënat individuale të mbledhura nga njësia statistikore për nxjerrjen e statistikave zyrtare do të përdoren vetëm për qëllime statistikore ”.

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankimin nr. 442 Prot., datë 02.03.2018 pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeht ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit dhe konkretisht pranimin e ankesës dhe detyrimin e Institutit të Statistikave të informojë në lidhje me:

- Sa është numri i të punësuarve në secilën prej call center që operojnë në Tiranë?
- Cilët janë 10 Call center më të mëdhenj që operojnë në Tiranë në bazë të numrit të punonjësve?

Komisioneri, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes me Urdhrin nr. 95, datë 07.03.2018, vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave që janë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Me emailin e datës 08.03.2018, Koordinatorin për të drejtën e informimit ka sqaruar Zyrën e Komisionerit se, bazuar në Ligjin nr. 9180, datë 05.02.2004 “Për statistikën zyrtare”, i ndryshuar, Instituti i Statistikave ka kthyer përgjigje për atë që e lejon ligji, në lidhje me garantimin e konfidencialitetit statistikor, mbështetur në nenin 4, shkronja “dh” dhe nenin 15, pikat 2, 5 dhe 6, sipas të cilit:

dh) “Konfidencialiteti statistikor” është mbrojtja e të dhënave që lidhen me njësi statistikore të veçanta, të cilat janë marrë direkt për qëllime statistikore ose indirekt nga burime administrative ose të tjera kundër çdo shkelje të së drejtës së konfidencialitetit. Kjo nënkupton parandalimin e përdorimit jo-statistikor të të dhënave të marra dhe zbulimin e pjesshëm.

2. Të dhënat e mbledhura, të përpunuara dhe të ruajtura për nxjerrjen e statistikave zyrtare do të trajtohen si konfidenciale nga INSTAT-i, agjencitë statistikore dhe çdo organizatë ose person i caktuar prej tyre, kur këto të dhëna bëjnë që njësitë statistikore të identifikohen drejtpërdrejt ose tërthorazi, duke zbuluar të dhëna individuale, që nuk janë bërë publike për arsye të tjera.

5. Të gjithë punonjësit e organeve/kontrolluesve, të përmendur në paragrafin e parë të kësaj pike, të cilët vihen në dijeni me të dhënat që përpunojnë gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin e besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit.

Të gjitha të dhënat individuale të mbledhura nga njësia statistikore për nxjerrjen e statistikave zyrtare do të përdoren vetëm për qëllime statistikore. Këto të dhëna do të botohen vetëm bashkërisht dhe nuk do të përdoren për të marrë ndonjë vendim administrativ, duke përfshirë këtu vendime për kontrollin fiskal ose hetime juridike.

6. E drejta e hyrjes në të dhënat konfidenciale do të kufizohet për personat, të cilët, gjatë kryerjes së detyrave, kontribuojnë në nxjerrjen e statistikave zyrtare. E drejta e hyrjes do të shtrihet në masën që për këto të dhëna është i nevojshëm për nxjerrjen e statistikave në fjalë. E drejta e hyrjes për qëllime kërkimore-shkencore do të kufizohet në përputhje me pikën 7 të këtij neni.

Në përfundim të këtij arsytimi Autoriteti Publik citon se, publikimi i këtij informacioni është në kundërshtim me nenin 15 pika 5 e ligjit “Për statistikën zyrtare”.

Zyra e Komisionerit konstaton se, autoriteti publik nuk ka bërë një analizë të mirëfilltë të asaj që lejohet të bëhet publike apo jo.

Në lidhje me pretendimin e autoritetit publik se të dhënat e mbledhura, të përpunuara dhe të ruajtura për nxjerrjen e statistikave zyrtare **do të trajtohen konfidenciale** nga Instituti i Statistikave (në referim të nenit 15 pika 2), sjellim në vëmendje se në rastin objekt shqyrtimi kërkohet informacion për shoqëri tregtare që operojnë në kryeqytet dhe informacioni i kërkuar gjendet tashmë i publikuar në regjistra publikë (siç janë Regjistri Tregtar i mbajtur nga QKB, zyra e tatimeve dhe ajo e punës, ku deklarohen të dhëna lidhur me shoqëritë tregtare, numrin e punonjësve të tyre, etj) dhe për rrjedhojë, ky informacion nuk i nënshtrohet kufizimeve për shkak të konfidencialitetit.

Sa më sipër, bazuar në pikën 2, të nenit 2 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, informacion publik konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik. Pra qartazi duket se kemi të bëjmë me kërkesë për dhënien e një informacioni publik nga autoriteti publik.

Gjithashtu, në pikën 3, të nenit 3 të tij, parashikohet se: “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”. Edhe në rast se Autoriteti Publik do të vlerësonte se kemi të bëjmë me kufizime neni 17 pika 6 i Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” parashikon se: “Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit...”.

E drejta e informimit, bën pjesë në grupin e të drejtave themelore të njeriut, të mbrojtura posaçërisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ). Organet e administratës publike janë të detyruara t’i nënshtrohen parashikimeve kushtetuese dhe të konventës, por dhe atyre të parashikuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, me qëllim garantimin efektiv të parimit të transparencës.

Kështu, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon:

**Neni 15** “1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik.  
2. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.”

**Neni 23** “E drejta e informimit është e garantuar. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore.”

Ndërsa në nenin 10 të KEDNJ është përcaktuar se : “Çdo kush ka të drejtë e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë.”

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Qendrës “Res Publica” ndaj Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

### PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 ‘Për të drejtën e informimit’, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’,

### V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Qendrës “Res Publica”, Nr. 442 Prot., datë 02.03.2018, ndaj Autoritetit Publik “Instituti i Statistikave”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar në pikën 3 dhe 4 të kërkesës, konkretisht:
  - Sa është numri i të punësuarve në secilën prej call center që operojnë në Tiranë;
  - Cilët janë 10 Call center më të mëdhenj që operojnë në Tiranë në bazë të numrit të punonjësve; brenda datës 10. 7 .2018.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, sipas nenit 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 3 . 7 .2018.

### KOMISIONERI

Besnik Dervishi

